| | | |
|---|---|---|
| Institucioni Raportues | | Ministria e Arsimit |
| Periudha e Raportimit | | JANAR-QERSHOR 2026 |
| Numri i Masave për tu raportuar | 3 | |

Qëllimi i politikës C: Arsim i lartë gjithëpërfshirës që përmbush standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik e transparencës dhe është promotor i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit.

I Objektivi specifik C1: Rritja e cilësisë së arsimit të lartë përmes riorganizimit të programeve të studimit, modernizimit të infrastrukturës akademike dhe zbatimit të standardeve të larta të vlerësimit institucional dhe të programeve të studimit.

| Nr.1 | Masat | Afati Kohor | Rezultatet e pritshme | Indikatorët | Niveli i zbatimit | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | E zbatuar | E pazbatuar | Pjesërisht | Në proces |
| 1 | C.1.1 Programet e IAL-ve ndërtohen mbi rezultatet e të nxënit dhe janë të krahasueshme me programet e IAL-ve evropiane. | TM2 2023-TM2–2024 | C.1.1.3 Realizimi i kodifikimit të programeve të studimit. | | | | | |

**Raportimi mbi zbatimin e masës :**

Gjatë periudhës janar–qershor 2026, Sektori i Sigurimit të Cilësisë dhe Akreditimit ka monitoruar dhe koordinuar procesin e kodifikimit të programeve të studimit në bashkëpunim me njësitë kryesore dhe njësitë bazë. Është verifikuar përputhshmëria e programeve me rezultatet e të nxënit, sistemin ECTS, Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe standardet e sigurimit të cilësisë. Gjithashtu, janë shqyrtuar dhe përditësuar dokumentet e programeve të studimit, në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë dhe përgatitjes së dokumentacionit për proceset e akreditimit dhe riakreditimit. Fushat e studimit që ofrohen nga institucioni ynë sipas VKM 310, dt. 11.05.2022 janë përkatësisht: 1, 2, 4, 5, 6, 7, 9 dhe 10. Nismat që janë ndërmarrë për çeljen e programeve të reja si dhe riorganizimet e shume programeve ekzistuese kanë qenë në zbatim të kornizës së standardeve të europiane të arsimit të lartë. Hapat e ndërmarrë nga UV-ja, tregojnë transparencë, besueshmëri, rritje, bashkëpunime të reja kombëtare dhe ndërkombëtare, përmirësim i vazhdueshëm i cilësisë duke përdorur instrumenta të ndryshëm. Për periudhën raportuese janar-qershor 2026 janë miratuar hapja e programeve të reja: 1. Bachelor në "Teknik Laboratori" me urdhër hapje 276/30.06.2026; 2. Diplomë profesionale në "Dermoestetikë profesionale" me urdhër hapje 269/30.06.2026.

**Arsyet e mozbatimit ( në rast kur masa nuk është zbatuar)**

**Raportimi Financiar**

| Shpenzimet/Alokimet | | Buxheti i shtetit | Donatori/ët | Burime të tjera |
|---|---|---|---|---|
| Shpenzimet financiare | | | | |
| Alokimet e pritura | | | | |

Rekomandime:

| Nr.2 | Masa | Afati Kohor | Rezultatet e pritshme | Indikatorët | Niveli i zbatimit | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | E zbatuar | E pazbatuar | Pjesërisht | Në proces |
| 2 | C.1.2 Përmirësimi i infrastrukturës akademike. | TM1 2021-TM4 2026 | C.1.2.1 Investime në zgjerimin dhe përmirësimin e infrastrukturës akademike (godinat, kampuset, laboratorët, bibliotekat etj.) | | | | | |

**Raportimi mbi zbatimin e masës**

**Investime në zgjerimin dhe përmirësimin e infrastrukturës akademike (godinat, kampuset, laboratorët, bibliotekat etj. finnacuar nga UV**

| Grupi | Kap. | Artikulli | Emertimet | Vlera/Leke |
|---|---|---|---|---|
| 11 | 6 | 231 | Likujdim Blerje paisje elektronike per vitin 2026 | 10,018,800 |
| 11 | 6 | 231 | F.V Paisje elktronike | 6,852,000 |
| 11 | 6 | 231 | Blerje dhe instalim I kondicionereve per vitin 2025 | 5,204,760 |
| 11 | 6 | 231 | F.V Blerje dyersh per ambientet e UV-se | 321,600 |
| 11 | 6 | 231 | Likujdim ndertim I shkalleve dhe rampave metalike per FE dhe FSHH | 669,600 |
| 11 | 6 | 231 | Blerje smart board dhe postera dixhital per nevoja te UV-se | 15,039,960 |
| 11 | 6 | 231 | Rikonceptim I salles C 500 | 5,110,920 |
| **TOTALI** | | | | **43,217,640** |

**Investime në zgjerimin dhe përmirësimin e infrastrukturës akademike (godinat, kampuset, laboratorët, bibliotekat etj. finnacuar nga Buxheti I Shtetit**

| Grupi | Kap. | Artikulli | Emertimet | Vlera/Leke |
|---|---|---|---|---|
| 11 | 8 | 231 | Blerje paisje per ngritjen e Qendres Shkencore per Monitorimin dhe ekologjine detare | 5,070,000 |
| **TOTALI** | | | | **5,070,000** |

**Arsyet e mozbatimit ( në rast kur masa nuk është zbatuar)**

**Raportimi Financiar**

| Shpenzimet/Alokimet | | Buxheti i shtetit | Donatori/ët | Burime të tjera |
|---|---|---|---|---|
| Shpenzimet financiare | | 5,070,000 | | 43,217,640 |
| Alokimet e pritura | | | | |

Rekomandime:

| | | |
|---|---|---|
| Institucioni Raportues | | Ministria e Arsimit |
| Periudha e Raportimit | | JANAR-QERSHOR 2026 |
| Numri i Masave për tu raportuar | 1 | |

Qëllimi i politikës C: Arsim i lartë gjithëpërfshirës që përmbush standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik e transparencës dhe është promotor i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit.

II Objektivi specifik C2 Nxitja e përsosmërisë në mësimdhënie dhe kërkim.

| Nr.1 | Masat | Afati Kohor | Rezultatet e pritshme | Indikatorët | Niveli i zbatimit | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | E zbatuar | E pazbatuar | Pjesërisht | Në proces |
| 1 | **C.2.1** Përmirësimi i kapacitetit të personelit akademik në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. | TM2 2022-TM4–2026<br>TM2 2022-TM3 2026<br>TM2 2022-TM4 2025 | **C.2.1.1** Nxitja e krijimit të qendrave në universitete për trajnimin në mësimdhënie dhe kërkim.<br>**C.2.1.2** Zbatimi i incentivave për rezultate në punën shkencore.<br>**C.2.1.3** Masa nxitëse për bashkëpunime institucionale midis akademikëve të diasporës dhe institucioneve të arsimit të lartë. | | | | | |

C.2.1.1 Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë ka konsoliduar mekanizmat institucionalë për zhvillimin profesional të stafit akademik në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, nëpërmjet veprimtarisë së Qendrës së Zhvillimit Rajonal (QZHR) dhe Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Projekteve. Këto struktura organizojnë dhe koordinojnë trajnime, seminare, workshope dhe aktivitete për ngritjen e kapaciteteve të stafit akademik në metodologjinë e kërkimit, hartimin dhe menaxhimin e projekteve, inovacionin, transferimin e njohurive dhe metodat bashkëkohore të mësimdhënies. Gjithashtu, në kuadër të projekteve ndërkombëtare Erasmus+ dhe Horizon Europe, si SMART, CRED4TEACH, INTEC, ZERO-C dhe projekte të tjera, universiteti ka zhvilluar programe të shumta trajnimi, mobilitete dhe aktivitete për zhvillimin e kompetencave akademike, duke kontribuar në krijimin e një sistemi të qëndrueshëm të formimit të vazhdueshëm të stafit dhe forcimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Universiteti do të vijojë të zgjerojë këto mekanizma, duke fuqizuar bashkëpunimin me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë dhe duke rritur ofertën e programeve të trajnimit në përputhje me prioritetet e Strategjisë Kombëtare të Arsimit të Lartë. C.2.1.2 Zbatimi i incentivave për rezultate në punën shkencore. Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë ka krijuar dhe zbaton një kuadër të plotë rregullator dhe financiar për mbështetjen dhe incentivimin e veprimtarisë kërkimore të stafit akademik. Në këtë kuadër, është miratuar Rregullorja Financiare për Financimin e Veprimtarisë Kërkimore, me Vendimin nr. 45, datë 05.12.2023 të Bordit të Administrimit, e cila përcakton mekanizmat e financimit dhe administrimit të fondeve për kërkimin shkencor. Gjithashtu, universiteti zbaton Rregulloren e Programit të Kërkimit Shkencor të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë (PKZHUV), miratuar me Vendimin nr. 125, datë 15.12.2025 të Senatit Akademik, e ndryshuar me Vendimin nr. 14, datë 11.03.2026, e cila rregullon procedurat për financimin konkurrues të projekteve kërkimore, kriteret e vlerësimit, monitorimin dhe raportimin e rezultateve. Përmes këtij programi, universiteti financon çdo vit projekte kërkimore të propozuara nga stafi akademik, duke nxitur cilësinë e kërkimit shkencor, bashkëpunimin ndërdisiplinor dhe adresimin e prioriteteve të zhvillimit institucional e kombëtar. Paralelisht, universiteti mbështet pjesëmarrjen e stafit akademik në programe kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkimit dhe inovacionit, duke ofruar asistencë teknike dhe administrative gjatë aplikimit dhe zbatimit të projekteve. Këto masa kanë kontribuar në rritjen e pjesëmarrjes së stafit akademik në veprimtarinë kërkimore, zgjerimin e portofolit të projekteve të financuara dhe forcimin e kulturës së ekselencës shkencore në universitet.C.2.1.3 Masa nxitëse për bashkëpunime institucionale midis akademikëve të diasporës dhe institucioneve të arsimit të lartë.Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë ka ndërmarrë masa konkrete për forcimin e bashkëpunimit me akademikët shqiptarë të diasporës, duke krijuar mundësi për përfshirjen e tyre në veprimtarinë akademike dhe kërkimore të universitetit. Në kuadër të projekteve ndërkombëtare dhe iniciativave institucionale, universiteti ka angazhuar akademikë të diasporës si lektorë, ekspertë, mentorë dhe partnerë në aktivitete shkencore dhe të zhvillimit të kapaciteteve. Konkretisht:

- në kuadër të projektit READ, janë organizuar aktivitete të përbashkëta kërkimore dhe zhvillimi profesional me pjesëmarrjen e akademikëve shqiptarë të diasporës*(Në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore, projekti me temë: “Integrated Phenotypic, Physiological and Molecular Analyses to Unlock Albanian Wheat Germplasm Potential under Water Stress”, me koordinator Dr. Blerta Laze dhe me mbështetjen e përfaqësuesit të Diasporës PhD. Ilva Licaj (Università Degli Studi Del Sannio, Benevento, Italy).
Në Fakultetin e Shëndetit, projekti me temë: “A Digital Behavioral Intervention to Improve Hypertension Self-Care in Albania: Development and Implementation Study” me koordinator PhD. Jerina Jaho me mbështetjen e përfaqësuesit të Diasporës PhD. Erand Llanaj (Faculty of Medicine OWL,  Bielefeld University, Germany).
- përmes Shkollave Verore (Summer Schools) dhe workshopeve ndërkombëtare, janë krijuar mundësi për shkëmbimin e njohurive, rrjetëzimin akademik dhe zhvillimin e bashkëpunimeve të qëndrueshme ndërmjet stafit akademik të universitetit dhe studiuesve shqiptarë që ushtrojnë veprimtarinë e tyre jashtë vendit(workshop-i ndërkombëtar me temë “Workshop on Foundations of AI Prof Artur Elezaj ;
- në kuadër të projekteve Jean Monnet, universiteti ka bashkëpunuar me ekspertë dhe akademikë shqiptarë të diasporës në organizimin e leksioneve të hapura, aktiviteteve shkencore dhe nismave për promovimin e studimeve evropiane dhe ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë(Në kuadër të Jean Monnet Project, u zhvillua një leksion i hapur me temë: “Rritja Ekonomike dhe Qeverisja në Ballkanin Perëndimor: Një rrugë drejt integrimit në BE”,Harvard University, Prof. Dr. Albana Shehaj)
Këto iniciativa kanë kontribuar në forcimin e lidhjeve institucionale me komunitetin akademik shqiptar jashtë vendit, në transferimin e njohurive dhe përvojave bashkëkohore, si dhe në zgjerimin e bashkëpunimeve ndërkombëtare në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

| | | | Investime në zgjerimin dhe përmirësimin e infrastrukturës akademike (godinat, kampuset, laboratorët, bibliotekat etj. finnacuar nga UV | |
|---|---|---|---|---|
| **Grupi** | **Kap.** | **Artikulli** | **Emertimet** | **Vlera/Leke** |
| 11 | 6 | 231 | Pushim kafeje per aktivitetin "Workshop in foundation of AI" | 120,000 |
| 11 | 6 | 231 | Organizim darke per te ftuarit ne aktivitetin "Workshop in foundation of AI" | 145,000 |
| 11 | 6 | 231 | Blerje materiale promovuese per organizimin e aktivitetit "Workshop in foundation of AI" | 153,600 |
| 11 | 6 | 231 | Akomodim dhe sherbim kateringu per te ftuarit ne aktivitetin "Workshop in foundation of AI" | 401,800 |
| 11 | 6 | 231 | Organizim kateringu per konferencen e III-te te studenteve | 60,000 |
| 11 | 6 | 231 | Blerje materiale promovuese per organizimin e konferencen e III-te te studenteve | 162,000 |
| 11 | 6 | 231 | Projekti READ | 45,000 |
| | | | **TOTALI** | **1,087,400** |

| Nr. | Projekti | janar - qershor 2026 |
|---|---|---|
| 1 | SMART | 750,558 |
| 2 | CREAD4TEACH | 517,780 |
| 3 | INTEC | 2,133,876 |
| 4 | ZERO C | 49,896 |
| | **TOTALI** | **3,452,110** |

Arsyet e mozbatimit ( në rast kur masa nuk është zbatuar)

Raportimi Financiar

| Shpenzimet/Alokimet | | Buxheti i shtetit | Donatori/ët | Burime të tjera |
|---|---|---|---|---|
| Shpenzimet financiare | | | 3,452,110 | 1,087,400 |
| Alokimet e pritura | | | | |

Rekomandime:

| | | |
|---|---|---|
| Institucioni Raportues | | Ministria e Arsimit |
| Periudha e Raportimit | | JANAR-QERSHOR 2026 |
| Numri i Masave për tu raportuar | 3 | |

Qëllimi i politikës C: Arsim i lartë gjithëpërfshirës që përmbush standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik e transparencës dhe është promotor i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit.

III Objektivi specifik C3 Ndërlidhja më e mirë e arsimit të lartë me tregun e punës.

| Nr.1 | Masat | Afati Kohor | Rezultatet e pritshme | Indikatorët | Niveli i zbatimit | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **C.3.1** Harmonizimi i programeve në IAL me kërkesat e tregut të punës | TM1 2022-TM3 2026<br>TM1 2022-TM4 2026<br>TM2 2022-TM2 2023<br>TM2 2022-TM4 2026<br>TM3 2022-TM4 2026<br>TM3 2021-TM4 2026 | **C.3.1.1** Pasurimi i ofertës së programeve profesionale.<br>**C.3.1.2** Paketa e programit të inovacionit dhe ekselencës në manifakturë dhe IT-së.<br>**C.3.1.3** Krijimi i një regjistri qendror të studentëve të diplomuar në IAL-të shqiptare.<br>**C.3.1.4** Analiza e vazhdueshme e ecurisë së studentëve të diplomuar sipas sektorëve, do të krijojë mundësinë e orientimit të kuotave sipas degëve përkatëse, në raport me kërkesat.<br>**C.3.1.5** Ofrimi i programeve të formimit të vazhdueshëm.<br>**C.3.1.6** Krijimi i projekteve të përbashkëta të bashkëpunimit midis shoqatave të biznesit dhe universiteteve. | | E zbatuar | E pazbatuar | Pjesërisht | Në proces |

**Raportimi mbi zbatimin e masës :**

Programi Profesional "Dermoestetikë Profesionale" është miratuar me Urdhrin e Ministrit të Arsimit nr. 269, datë 30.06.2026, dhe ofrohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
Sektori i Kurrikulave dhe Statistikës mban dhe administron regjistrin elektronik të të diplomuarve të UV-së, duke garantuar regjistrimin, përditësimin dhe pasqyrimin e saktë të të dhënave në sistemin SMIAL.
Universiteti vijon të ofrojë programin e formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike, me synim zhvillimin profesional dhe përditësimin e vazhdueshëm të njohurive dhe kompetencave të pjesëmarrësve, në përputhje me standardet dhe kërkesat e arsimit të lartë.

**Arsyet e mozbatimit ( në rast kur masa nuk është zbatuar)**

**Raportimi Financiar**

| Shpenzimet/Alokimet | | Buxheti i shtetit | Donatori/ët | Burime të tjera |
|---|---|---|---|---|
| Shpenzimet financiare | | | | |
| Alokimet e pritura | | | | |

Rekomandime:

| Nr.2 | Masa | Afati Kohor | Rezultatet e pritshme | Indikatorët | Niveli i zbatimit | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | **C.3.2** Rritja e mundësive për punë praktike në studimet e larta. | TM3 2022-TM3 2026 | **C.3.2.1** Krijimi/funksionalizimi i zyrave të karrierës në IAL-të publike. | | E zbatuar | E pazbatuar | Pjesërisht | Në proces |

**Raportimi mbi zbatimin e masës**

Në kuadër të veprimtarisë së Sektorit të Këshillimit të Karrierës, Shërbimit të Studentëve dhe Alumnit, sigurohet funksionalizimi i shërbimeve të karrierës për studentët dhe të diplomuarit, përmes orientimit profesional, këshillimit në karrierë, organizimit të aktiviteteve informuese, trajnimeve, praktikave profesionale, bashkëpunimit me punëdhënësit dhe ndjekjes së të diplomuarve.
Nëpërmjet këtyre veprimtarive, sektori synon të rrisë punësueshmërinë e studentëve, të lehtësojë kalimin nga studimet në tregun e punës dhe të forcojë lidhjen ndërmjet universitetit dhe tregut të punës..

**Arsyet e mozbatimit ( në rast kur masa nuk është zbatuar)**

**Raportimi Financiar**

| Shpenzimet/Alokimet | | Buxheti i shtetit | Donatori/ët | Burime të tjera |
|---|---|---|---|---|
| Shpenzimet financiare | | | | |
| Alokimet e pritura | | | | |

Rekomandime:

| Nr. 3 | Masa | Afati Kohor | Rezultatet e pritshme | Indikatorët | Niveli i zbatimit | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 | **C.3.3** Promovimi i ndërdisiplinaritetit dhe programeve STEM. | TM3 2022-TM3 2026 | **C.3.3.1** Zhvillimi/reformimi i programeve ndërdisiplinore dhe programeve STEM. | | E zbatuar | E pazbatuar | Pjesërisht | Në proces |

**Raportimi mbi zbatimin e masës**

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Në kuadër të Strategjisë së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë për periudhën TM3 2022–TM3 2026, Qendra e Zhvillimit Rajonal ka kontribuar në promovimin e ndërdisiplinaritetit dhe zhvillimin e kompetencave STEM, përmes aktiviteteve të lidhura me inovacionin, teknologjinë, zhvillimin e qëndrueshëm dhe përgatitjen e studentëve për tregun e punës.<br>Për masën C.3.3.1, "Zhvillimi/reformimi i | 2025-2026 | 5 programe multidisiplinore te zhvilluara dhe te akredituar | mbi 220 pjesemarres ne keto kurse trajnimi , 198 te certifikuar | po | | | |

**Arsyet e mozbatimit ( në rast kur masa nuk është zbatuar)**

**Raportimi Financiar**

| Shpenzimet/Alokimet | | Buxheti i shtetit | Donatori/ët | Burime të tjera |
|---|---|---|---|---|
| Shpenzimet financiare | | | | |
| Alokimet e pritura | | | | |

Rekomandime:

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Institucioni Raportues | | | Ministria e Arsimit | | | | | |
| Periudha e Raportimit | | | JANAR-QERSHOR 2026 | | | | | |
| Numri i Masave për tu raportuar | | 1 | | | | | | |
| Qëllimi i politikës C: Arsim i lartë gjithëpërfshirës që përmbush standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik e transparencës dhe është promotor i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit. | | | | | | | | |
| IV | Objektivi specifik C4 Sigurimi i integritetit akademik, transparencës dhe llogaridhënies në sektorin e arsimit të lartë. | | | | | | | |
| Nr.1 | Masat | Afati Kohor | Rezultatet e pritshme | Indikatorët | Niveli i zbatimit | | | |
| 1 | C.4.1 Sigurimi i transparencës dhe zbatimi i praktikave të mira të integritetit akademik në IAL. | TM2 2022-TM3 2022<br>TM2 2022-TM2 2023<br>TM3 2021-TM4 2022<br>TM2 2022-TM2 2023 | C.4.1.1 Zhvillimi i rregulloreve për publikimin e të dhënave dhe dokumenteve përkatëse në faqen e internetit të IAL-ve (Open Data).<br>C.4.1.2 Miratimi i kodeve etike institucionale në të gjitha IAL-të.<br>C.4.1.3 Instalimi i softuerit antiplagjiaturë në IAL-të publike.<br>C.4.1.4 Ndërtimi i kapacitetit të organeve kolegjiale të IAL-ve publike për të siguruar respektimin e parimeve të integritetit akademik, transparencës dhe llogaridhënies. | | E zbatuar | E pazbatuar | Pjesërisht | Në proces |
| | Raportimi mbi zbatimin e masës : | | | | | | | |
| | Ne lidhje me piken 4.1.2 Universiteti eshte ne proces per hartimin e kodit te ri te etikes; VSA nr. 1/20.06.2026 për miratimin e rregullores së sistemit kompjuterik UNVIMAS. VSA nr. 12/11.03.2026 për miratimin e rregullores së komiteteve shkencore të UV-së; VSA nr.13/11.03.2026 për miratimin e rregullores për organizmin, funksionimin dhe kompetencat e komitetit të etikes në kërkim në UV; Përpos vendimeve të sipërpërmendura, janë ndërmarrë dhe vendime senati mbi miratimet e rregulloreve të çdo programi studimi, rregullore fakultetesh si dhe rregullore e SSBCA. Për herë të parë është bërë e mundur certifikimi i sistemit UNVIMas - E-University, me nr. regjistrimi **27818.** | | | | | | | |
| | Arsyet e mozbatimit ( në rast kur masa nuk është zbatuar) | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | Raportimi Financiar | | | | | | | |
| | Shpenzimet/Alokimet | | Buxheti i shtetit | Donatori/ët | Burime të tjera | | | |
| | Shpenzimet financiare | | | | | | | |
| | Alokimet e pritura | | | | | | | |

Rekomandime:

| | | |
|---|---|---|
| Institucioni Raportues | | Ministria e Arsimit |
| Periudha e Raportimit | | JANAR-QERSHOR 2026 |
| Numri i Masave për tu raportuar | 2 | |

Qëllimi i politikës C: Arsim i lartë gjithëpërfshirës që përmbush standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik e transparencës dhe është promotor i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit.

IV

Objektivi specifik C5 Përmirësimi i statusit socio-ekonomik të studentëve përmes ofrimit të shërbimeve cilësore dhe formave të ndryshme të ndihmës financiare.

| Nr.1 | Masat | Afati Kohor | Rezultatet e pritshme | Indikatorët | Niveli i zbatimit | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **C.5.1** Pasurimi dhe përmirësimi i shërbimeve për studentët. | TM3 2021-TM4–2026<br>TM3 2022-TM4 2026<br>TM3 2021-TM4 2026 | **C.5.1.1** Dhënia e bursave për studentët ekselent dhe studentët në nevojë.<br>**C.5.1.2** Ndërmjetësim për punësimin e studentëve.<br>**C.5.1.3** Zgjerimi i listës së shërbimeve të favorizuara për studentët mbi bazën e kartës së studentit. | | E zbatuar | E pazbatuar | Pjesërisht | Në proces |

**Raportimi mbi zbatimin e masës :**

1.Në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë është miratuar dhe është vënë në zbatim Karta e Studentit, e cila u ofron studentëve një gamë shërbimesh dhe lehtësish falas, si dhe përfitime të ndryshme në fusha me interes për jetën studentore. Kjo nismë synon të mbështesë mirëqenien e studentëve, të lehtësojë aksesin e tyre në shërbime publike dhe të nxisë përfshirjen aktive të tyre në jetën sociale, kulturore dhe akademike të qytetit.

2.Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë, ka krijuar dhe vënë në dispozicion një fond të veçantë për mbështetjen financiare të Këshillit Studentor, me qëllim fuqizimin e rolit të tij si organ përfaqësues i studentëve dhe rritjen e pjesëmarrjes së tyre aktive në jetën universitare. Ky fond shërben për financimin e aktiviteteve, nismave dhe projekteve të propozuara nga Këshilli Studentor në fusha të ndryshme, si veprimtari akademike, kulturore, sociale, sportive dhe ndërgjegjësuese.

3.Në kuadër të bashkëpunimit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, me partnerë nga sektori publik dhe privat, studentëve u ofrohen vazhdimisht mundësi konkrete punësimi, praktikash profesionale dhe bursash. Nëpërmjet aktiviteteve të organizuara nga universiteti dhe partnerët e tij, kompani dhe institucione të njohura, si Wizz Air, Raiffeisen Bank, Green Coast dhe Vlora Marina, kanë prezantuar oferta konkrete punësimi dhe mundësi zhvillimi profesional për studentët dhe të diplomuarit.

Këto partneritete u krijojnë studentëve mundësinë të njihen drejtpërdrejt me kërkesat e tregut të punës, të aplikojnë për pozicione të lira pune dhe praktika profesionale, si dhe të përfitojnë nga programe bursash dhe mbështetje financiare të ofruara nga kompani të ndryshme. Kjo qasje kontribuon në rritjen e punësueshmërisë së studentëve, lehtëson kalimin e tyre nga universiteti në tregun e punës dhe forcon lidhjen ndërmjet programeve të studimit dhe nevojave të ekonomisë dhe biznesit.

Në zbatim të Vendimit të Rektoratit nr. 3, datë 03.02.2025, "Për procedurën e përzgjedhjes së studentëve bursistë, të financuara prej subjekteve të treta", studentët e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë kanë përfituar bursa studimi të financuara nga subjektet Marina Residence Vlorë dhe ALSAR, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në këtë vendim. Këto bursa synojnë të mbështesin studentët me rezultate të larta akademike, duke nxitur ekselencën dhe duke forcuar bashkëpunimin ndërmjet universitetit dhe partnerëve të tij strategjik.  Studentët ekselent, si dhe studentë në nevojë kanë përfituar bursa, duke u mbështetur në vendimet e bordit nr. 24/16.04.2026; nr.30/21.05.2026.

**Arsyet e mozbatimit ( në rast kur masa nuk është zbatuar)**

**Raportimi Financiar**

| Shpenzimet/Alokimet | | Buxheti i shtetit | Donatori/ët | Burime të tjera |
|---|---|---|---|---|
| Shpenzimet financiare | | | | |
| Alokimet e pritura | | | | |

Rekomandime:

| Nr.2 | Masa | Afati Kohor | Rezultatet e pritshme | Indikatorët | Niveli i zbatimit | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **C.5.2** Mbështetja e studentëve për përmirësimin e arritjeve akademike. | TM3 2022-TM4 2026 | **C.5.2.1** Tutorimi/mentorimi i studentëve në të gjitha IAL-të. | | E zbatuar | E pazbatuar | Pjesërisht | Në proces |

Organizimi i seminareve dhe trajnimeve për zhvillimin profesional të studentëve. Nëpërmjet organizimit të seminareve, dhe sesioneve informuese, studentët mbështeten në hartimin e CV-së dhe letrës së motivimit, përgatitjen për intervista pune, orientimin në karrierë dhe zhvillimin e aftësive të nevojshme për integrimin e suksesshëm në tregun e punës.Mbështetja Akademike për Studentët
Bashkëpunimi me njësitë akademike për ofrimin e këshillimit dhe mbështetjes akademike për studentët, përfshirë përfshirjen e studentëve me rezultate të larta si mentorë ose tutorë për bashkëmoshatarët.
Organizimi i sesioneve periodike të këshillimit në bashkëpunim me stafin akademik.
Mbështetja për Pjesëmarrjen në Konkurse dhe Aktivitete Akademike
Informimi dhe orientimi i studentëve për konkurse, konferenca, olimpiada dhe aktivitete akademike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
Bashkëpunimi me strukturat përkatëse të universitetit për ofrimin e mbështetjes organizative dhe, sipas mundësive, financiare për pjesëmarrjen e studentëve.
Krijimi dhe Funksionalizimi i Këshillit Studentor të UV-së

**Arsyet e mozbatimit ( në rast kur masa nuk është zbatuar)**

**Raportimi Financiar**

| Shpenzimet/Alokimet | | Buxheti i shtetit | Donatori/ët | Burime të tjera |
|---|---|---|---|---|
| Shpenzimet financiare | | | | |
| Alokimet e pritura | | | | |

Rekomandime:

| | | |
|---|---|---|
| Institucioni Raportues | | Ministria e Arsimit |
| Periudha e Raportimit | | JANAR-QERSHOR 2026 |
| Numri i Masave për tu raportuar | 4 | |

Qëllimi i politikës C: Arsim i lartë gjithëpërfshirës që përmbush standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik e transparencës dhe është promotor i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit.

I Objektivi specifik C6: Ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë në Shqipëri dhe integrimi në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA).

| Nr.1 | Masat | Afati Kohor | Rezultatet e pritshme | Indikatorët | Niveli i zbatimit | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | C.6.1 Nxitja e IAL-ve për të hapur programe studimi të përbashkëta me IAL-të evropiane ose programe në gjuhën angleze. | TM3 2021-TM4 2026 | C.6.1.1 Fondi për bashkëfinancimin e projekteve ndërkombëtare të bashkëpunimit akademik, përfshirë programet studimore të përbashkëta të IAL-ve shqiptare me universitetet evropiane. | | E zbatuar | E pazbatuar | Pjesërisht | Në proces |

**Raportimi mbi zbatimin e masës :**

**Arsyet e mozbatimit ( në rast kur masa nuk është zbatuar)**

**Raportimi Financiar**

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Shpenzimet/Alokimet | | Buxheti i shtetit | Donatori/ët | Burime të tjera |
| Shpenzimet financiare | | | | |
| Alokimet e pritura | | | | |

Rekomandime:

| Nr.2 | Masa | Afati Kohor | Rezultatet e pritshme | Indikatorët | Niveli i zbatimit | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | **C.6.2** Nxitja e IAL-ve për pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare të bashkëpunimit akademik. | TM2 2023-TM4 2026 | **C.6.1.2** Ngritja e zyrave të projekteve në IAL-të publike. | | E zbatuar | E pazbatuar | Pjesërisht | Në proces |

**Raportimi mbi zbatimin e masës**

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë ka konsoliduar funksionimin e Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Projekteve, si strukturë përgjegjëse për koordinimin e procesit të aplikimit, zbatimit dhe monitorimit të projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare. Sektori ofron mbështetje të vazhdueshme për njësitë akademike dhe stafin në identifikimin e mundësive të financimit, ndërtimin e partneriteteve ndërkombëtare, përgatitjen e aplikimeve, administrimin e projekteve dhe raportimin financiar e teknik. Gjatë periudhës janar -qershor 2026, sektori ka organizuar sesione informuese dhe trajnuese për programet Erasmus+, Horizon Europe, Interreg, COST, AKKSHI, Bridge, Read dhe programe të tjera, duke kontribuar në rritjen e kapaciteteve institucionale dhe të pjesëmarrjes së universitetit në programe konkurruese.Si rezultat i kësaj mbështetjeje, universiteti ka rritur ndjeshëm pjesëmarrjen në programet Erasmus+, Horizon Europe, Interreg IPA, ADRION, COST, READ dhe programe të tjera ndërkombëtare. Vetëm gjatë periudhes se raportimit universiteti ka aplikuar në 42 projekte ndërkombëtare (rezultate e te cileve pritet te dalin ne javet ne vijim), si dhe eshte shpallur fitues ne 1 projekt Horizon Europe dhe 3 projekte READ, duke dëshmuar rritjen e kapaciteteve institucionale dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar.

**Arsyet e mozbatimit ( në rast kur masa nuk është zbatuar)**

**Raportimi Financiar**

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Shpenzimet/Alokimet | | Buxheti i shtetit | Donatori/ët | Burime të tjera |
| Shpenzimet financiare | | | | |
| Alokimet e pritura | | | | |

Rekomandime:

| Nr. 3 | Masa | | Rezultatet e pritshme | Indikatorët | Niveli i zbatimit | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 | **C.6.3** Ofrimi i programeve studimore ndërkombëtare në Shqipëri. | TM3 2021-TM4 2026 | **C.6.3.1** Mbështetja e hapjes së degëve/programeve të universiteteve prestigjioze në Shqipëri. | | E zbatuar | E pazbatuar | Pjesërisht | Në proces |

**Raportimi mbi zbatimin e masës**

**Arsyet e mozbatimit ( në rast kur masa nuk është zbatuar)**

**Raportimi Financiar**

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Shpenzimet/Alokimet | | Buxheti i shtetit | Donatori/ët | Burime të tjera |
| Shpenzimet financiare | | | | |
| Alokimet e pritura | | | | |

Rekomandime:

| Nr.4 | Masa | | Rezultatet e pritshme | Indikatorët | Niveli i zbatimit | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | **C.6.4** Shtimi i mobilitetit të studentëve dhe personelit akademik. | TM3 2021-TM4 2026<br>TM3 2021-TM4 2026 | **C.6.4.1** Dhënia e bursave për mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve në bazë të meritokracisë.<br>**C.6.4.2** Krijimi i parakushteve për njohjen e krediteve të mobilitetit përmes përcaktimit të procedurave të qarta. | | E zbatuar | E pazbatuar | Pjesërisht | Në proces |

**Raportimi mbi zbatimin e masës**

Pika C.6.4, C.6.4.1 dhe C.6.4.2 është plotësuar në zbatim të rregullores për implementimin e marrëveshjeve ndërinstitucionale në kuadër të programeve Erasmus + KA 1 International Credit Mobility e miratuar me vendim të senatit akademik nr. 64 datë 21.05.2025.

**Arsyet e mozbatimit ( në rast kur masa nuk është zbatuar)**

**Raportimi Financiar**

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Shpenzimet/Alokimet | | Buxheti i shtetit | Donatori/ët | Burime të tjera |
| Shpenzimet financiare | | | | |
| Alokimet e pritura | | | | |

Rekomandime:

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | |
| Institucioni Raportues | | | Ministria e Arsimit | | | | | |
| Periudha e Raportimit | | | JANAR-QERSHOR 2026 | | | | | |
| Numri i Masave për tu raportuar | | 3 | | | | | | |
| Qëllimi i politikës C: Arsim i lartë gjithëpërfshirës që përmbush standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik e transparencës dhe është promotor i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit. | | | | | | | | |
| I | Objektivi specifik C7: Avancimi i infrastrukturës së TIK-ut dhe i shërbimeve digjitale për IAL-të publike. | | | | | | | |
| Nr.1 | Masat | Afati Kohor | Rezultatet e pritshme | Indikatorët | Niveli i zbatimit | | | |
| 1 | **C.7.1** Përmirësimi i infrastrukturës së TIK-ut në IAL dhe vizibilitetit në internet. | TM1 2022-TM4 2026<br><br>TM2 2022-TM3 2022 | **C.7.1.1** Investime në përmirësimin e infrastrukturës së TIK-ut në AL.<br>**C.7.1.2** Ofrimi i ndihmës IAL-ve për hartimin e politikave për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e faqeve të tyre të internetit. | | E zbatuar | E pazbatuar | Pjesërisht | Në proces |
| | Raportimi mbi zbatimin e masës : | | | | | | | |
| | Sektori IT ofron mirmbajtje the asistencë teknike në mundësimin e aksesit dhe trajnimit në LMS e krijuar nga stafi IT i UV | | | | | | | |
| | Arsyet e mozbatimit ( në rast kur masa nuk është zbatuar) | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | Raportimi Financiar | | | | | | | |
| | Shpenzimet/Alokimet | | Buxheti i shtetit | Donatori/ët | Burime të tjera | | | |
| | Shpenzimet financiare | | | | | | | |
| | Alokimet e pritura | | | | | | | |
| Rekomandime: | | | | | | | | |
| Nr.2 | Masa | Afati Kohor | Rezultatet e pritshme | Indikatorët | Niveli i zbatimit | | | |
| 2 | **C.7.2** Nxitja e IAL-ve për të organizuar mësimin në distancë dhe “të nxënit e kombinuar”. | TM1 2023-TM4 2026<br><br>TM1 2023-TM4–2026 | **C.7.2.1** Sigurimi i aksesit në ndonjë nga platformat LMS për IAL-të publike.<br>**C.7.2.2** Trajnim i stafit akademik për shfrytëzimin e platformave LMS. | | E zbatuar | E pazbatuar | Pjesërisht | Në proces |
| | Raportimi mbi zbatimin e masës | | | | | | | |
| | Sektori IT ofron asistencë teknike dhe trajnime në mundësimin e aksesit në bibliotekat dixhitale të renditura në faqen web të UV: https://univlora.edu.al/biblioteka | | | | | | | |
| | Arsyet e mozbatimit ( në rast kur masa nuk është zbatuar) | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | Raportimi Financiar | | | | | | | |
| | Shpenzimet/Alokimet | | Buxheti i shtetit | Donatori/ët | Burime të tjera | | | |
| | Shpenzimet financiare | | | | | | | |
| | Alokimet e pritura | | | | | | | |
| Rekomandime: | | | | | | | | |
| Nr. 3 | Masa | | Rezultatet e pritshme | Indikatorët | Niveli i zbatimit | | | |
| 3 | **C.7.3** Ofrimi i shërbimeve digjitale cilësore për studentët. | TM1 2022-TM4 2026<br><br>TM1 2023-TM4–2026 | **C.7.3.1** Sigurimi i aksesit në biblioteka digjitale.<br><br>**C.7.3.3** Digjitalizimi i sekretarive në të gjitha IAL-të publike. | | E zbatuar | E pazbatuar | Pjesërisht | Në proces |
| | Raportimi mbi zbatimin e masës | | | | | | | |
| | Në lidhje me objektivin C.7.3.1 kemi mundësuar akses në biblioteka dixhitale dhe është punuar për dixhitalizimin e bibliotekës qëndrore të UV. Në lidhje me objektivin C.7.3.1 sistemi UVMS mundëson dhe dixhitalizimin e sekretarive. | | | | | | | |
| | Arsyet e mozbatimit ( në rast kur masa nuk është zbatuar) | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | Raportimi Financiar | | | | | | | |
| | Shpenzimet/Alokimet | | Buxheti i shtetit | Donatori/ët | Burime të tjera | | | |
| | Shpenzimet financiare | | | | | | | |
| | Alokimet e pritura | | | | | | | |
| Rekomandime: | | | | | | | | |